

LIGJ
Nr.7672, datë 11.2.1993

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7652, DATË 23.12.1992 "PËR PRIVATIZIMIN E
BANESAVE SHTETËRORE"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, pas nenit 23 shtohet neni 23/a me këtë përmbajtje:

"Qytetarët që janë larguar jashtë vendit si emigrantë ekonomikë a politikë, pas datës 2 korrik 1990, gëzojnë të drejtën e privatizimit të banesës shtetërore që kanë pasur në përdorim me qira para emigrimit.

Në rastet kur banesa e emigrantit i është dhënë një qytetari tjetër me autorizim të organeve të pushtetit lokal dhe është lidhur kontrata e qirasë me ndërmarrjen komunale, sipas rregullave në fuqi deri më datën 31.12.1991, nuk bëhet privatizimi i saj. Në këto banesa qëndrojnë me qira personat që banojnë aktualisht me kontratë të rregullt. Çështjet që kanë të bëjnë me kohën e zgjatjes së qirasë, trajtimin dhe rregullat e privatizimit të këtyre banesave caktohen nga Këshilli i Ministrave.

Organet e pushtetit lokal ndërpresin veprimet e mëtejshme për prishjen e kontratave të qirasë së banesave të emigrantëve.

Neni 2

Të gjitha dispozitat ligjore e nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më datën 7.2.1993.

Shpallur me dekretin nr. 460, datë 16.2.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha